



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 139/2015 prot.

Pukë më, 22.10.2024

**VENDIM**

**Nr. 42, datë 16. 10. 2024.**

**“PËR  
VENDOSJE MEMORIALI”**

Këshilli i Bashkisë Pukë në mbledhjen e datës 16.10.2024, në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 54, neni 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar), si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pas shqyrtimit dhe diskutimit të anetareve;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë vendosjen e Memorialit në nder të martirëve të malsisë:  
Ndrek Markiçi, Ndue Dashi, Dedosh Jaku,  
Qun Gjergji, Hil Caka, Dom Gjon Gazulli  
Vendi i vendosjes së Memorialit do jetë pranë sheshit qendror “Gjergj Kastrioti - Skenderbeu”, në lulishten e trotuarit pranë pedonales, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Pukë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”
4. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.  
Vota të vlefshme gjithsej 11  
Vota pro 11, vota kunder 0, vota abstenim 0.

SEKRETARI


Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA



## Vendi i vendosjes se Memorialit





11.11.24

H. G. ...  
pen ...  
H. G. ...



H. G. ...  
1349/4  
11.11.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 725/1prot.

Shkodër, më 11.11.2024

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 42, datë 16.10.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë.

**KËSHILLIT BASHKIAK PUKË**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, neni 8, shkronja “a”, neni 56 i KPAD, Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 23 pika 14, neni 25, pika 1, neni 54, shkronja “ll”, neni 55/2/6, Materialit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Pukë Nr.1896/3prot datë.22.10.2024, analizoi *VKB Pukë nr.42, datë 16.10.2024 Për vendosjen e memorialit, pranë sheshit “Gjergj Kastrioti”, në nderë të martirëve: Ndrek Markiçi, Qun Gjergji, Ndue Dashi, Hil Caka, Dedosh Jaku dhe Dom Gjoni Gazulli”.*

Për sa trajtuar, Prefekti u njoh me vendimin e sipërcituar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

